



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 318, datë 19.12.2019**

**PËR**

**NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 pika 1, shkronjat “f”, “i” dhe “j”, si dhe në nenin 62, pika 14 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, duke vlerësuar rëndësinë që ka Hartimi i Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

**V E N D O S I :**

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nevojën institucionale për të patur një rregullim më të detajuar në lidhje me mirë funksionimin, rritjen e efikasitetit dhe cilësinë e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Komisioni i Përkohshëm për hartimin e rregullores së brendshme ka këtë përbërje:
  1. Z. Maksim Qoku - Kryetar
  2. Z. Medi Bici - Anëtar
  3. Znj. Brunilda Kadi - Anëtar
  4. Znj. Fatmira Luli - Anëtar
  5. Znj. Marçela Shehu - Anëtar
3. Komisioni koordinon punën e tij dhe fton për bashkëpunim përfaqësues të Misionit EURALIUS V, projektit “Drejtësi për të gjithë” – USAID, Prezencës së OSBE në Tiranë dhe projektit “SEJ III” – i Këshillit të Evropës.
4. Në përmbushje të punës së tij Komisioni merr masa dhe orienton administratën për të asistuar në mbarëvajtjen e punës së Komisionit.
5. Afati i ushtrimit të veprimtarisë të këtij komisioni është tre muaj nga momenti i ngritjes së tij, afat brenda të cilit, komisioni duhet të depozitohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor planin e përgatitur në funksion të qëllimit për të cilin është ngritur.
5. Komisioni mund të miratohet rregulla për funksionimin e veprimtarisë së tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**